

SHPENZIME STUDENTORE

Fatura nr: 01

Data: 01/10/2022

Klient: Student

1. Pagesë Qiraje
2. Blerje Ushqimesh
3. Transport
4. Libra
5. Blerje kancelarike
6. Blerje veshjesh
7. Argetim

TotalPara+Bursa

Totali pa paguar: Bursa



SKANO PËR TË PAGUAR

Dimri i gjatë i studentëve

RAPORT MONITORIMI

Nëntor - Janar
2022 - 2023



AUTOR

GEVIO TABAKU

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Vonesat në disbursimin e fondeve për studentët përfitues të bursave meritore dhe sociale

Për të paktën tre vitet e fundit, fondet që burojnë nga bursat meritore dhe sociale për studentët janë depozituar pranë llogarive të tyre bankare të paktën katër deri në pesë muaj me vonesë. Sipas pyetësorit të realizuar nga ana jonë (analiza e të cilit gjendet në vijim të këtij raporti), i cili iu drejtua studentëve të të gjitha niveleve dhe universiteteve publike në vend, rezulton se 98% e studentëve në Shqipëri që trajtohen me bursa të bazuara në meritë dhe nevojë nuk kanë marrë asnjë fond nga universitetet e tyre nga muaji tetor, 2022, deri në muajin janar, 2023¹. Kjo vonesë në pagesën e bursave nuk është një çështje e re pasi gjatë tre viteve të fundit këto fonde janë depozituar me vonesë.

Bursat janë një burim jetik i mbështetjes financiare për studentët në Shqipëri, pavarësisht se shuma monetare që buron nga këto bursa arrin në vlerën e 10 000 lekë në muaj. Këto bursa mund t'i ndihmojnë studentët të paguajnë shpenzime si qiraja, librat dhe shpenzimet e tjera të nevojshme të jetesës. Bursat e bazuara në meritë u jepen studentëve në bazë të arritjeve të tyre akademike, ndërsa bursa të bazuara në nevojë u jepen studentëve që vijnë nga kategori të ndryshme që konsiderohen në nevojë. Këto bursa, përveç mbështetjes modeste financiare me 10 000 lekë për muaj, u heqin studentëve edhe barrën e pagesës së tarifës vjetore të universiteteve dhe u ofrojnë atyre qasje në mundësi arsimore që ata nuk do të mund t'i gëzonin ndryshe.

Kategoria e studentëve që kualifikohen për bursë meritore/sociale, procesi i aplikimit dhe i përfitimit të bursës

Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016², "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", për të përfituar bursë, studentët duhet të plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:

¹ Pyetësori i zhvilluar në datë 9 janar 2023.

² <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/12/21/903>

1. Bursë meritore (bursa e ekselencës)

- a. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përlllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve;
- b. Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të vitit paraardhës akademik të përlllogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar

2. Bursë me bazë nevojë (bursë sociale)

- a. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;
- b. Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;
- c. Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
- d. Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
- e. Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;
- f. Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë
- g. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;
- h. Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjyqate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;
- i. Studentët që janë identifikuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç

- j. Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Për studentët përfitues të bursës meritore, të cilët regjistrohen për herë të parë në një universitet publik, duke iu referuar VKM-së së mësipërme, është Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) e cila ka si detyrim hartimin e listës së studentëve që gëzojnë notë mesatare mbi 9 (llogaritur si mesatare e thjeshtë e shkolles së mesme dhe notave të provimeve të maturës) pasi këta kandidatë regjistrohen në një universitet publik dhe marrin statusin e studentit. Më pas, kjo listë dërgohet pranë Ministrisë së Arsimit dhe universiteteve respektive.

Ajo çfarë është e çuditshme dhe krijon një parregullësi në gjithë zinxhirin e kësaj procedure është mospërcaktimi i afateve kohore për Qendrën e Shërbimeve Arsimore, ku hartuesit e ligjit janë mjaftuar vetëm duke përfshirë këtë fjali në pikën 1 të VKM-së: *"Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë."*

Duke mos patur asnjë afat kohor, QSHA nis procedurat e përfituesve të bursës së ekselencës të cilët sapo janë regjistruar në universitet kur e sheh vetë të arsyeshme. Kjo në fakt dëmton të gjithë procesin dhe është shkaktare kryesore e vonës së përvitshme të disbursimit të fondeve që u takojnë studentëve të sapo regjistruar nga bursa e ekselencës.

Në rastin e studentëve aktualë, në vitet e studimit pas të parit merret për bazë nota mesatare e ponderuar e vitit paraardhës kur kjo notë është nga 9 deri në 10, duke llogaritur këtu edhe kreditet e secilës lëndë mësimore si edhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve të vitit paraardhës akademik.

Studentët përfitues që trajtohen me bursë sociale duhet të kenë dokumentacionin vërtetues sipas kategorive të mësipërme në mënyrë që të përfitojnë bursën.

Pika 8 e VKM-së së mësipërme qartëson se aplikimi për bursë dhe dokumentacioni (në rastin e bursave sociale) dorëzohet në momentin e regjistrimit në universitet, ose në momentin e plotësimit të kriterëve. Më pas këto universitete kanë detyrimin e kryerjes së verifikimeve përkatëse, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës. Pasi kryhen edhe këto verifikime, paketa e aplikimit i dërgohet për shqyrtim dhe miratim Bordit të Administrimit të IAL-ve, të cilët kanë detyrim të marrin vendim mbi aplikimin brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së tij. Në këtë pikë, specifikohet gjithashtu se në rastet e aplikimit për bursë në fillim të vitit akademik, studenti duhet të paguhet duke filluar nga data e regjistrimit të tij në IAL, ose nga muaji pasardhës kur studenti ka paraqitur kërkesë në rast se plotëson kriteret e përcaktuara gjatë vitit akademik. Më rëndësi të lartë është edhe pika 11 e kësaj VKM-je, e cila saktëson se *pagesa në kuadër të bursave u jepen studentëve përfitues çdo muaj, në llogarinë bankare të deklaruar nga studentët.*

Vonesat e vazhdueshme dhe të tejzgjata të disbursimit të pagesave në llogaritë bankare të studentëve përfitues të këtyre bursave

Bazuar në specifikimet e mësipërme, duke marrë si shembull vitin akademik 2022-2023, dhe datat respektive të raundit të parë të aplikimit universitar, së bashku me kohëzgjatjen kohore të të gjitha procese siç ato specifikohen në VKM-në e mësipërme, kalendari i marrjes së bursave duhej të ishte si vijon:

Raundi i aplikimit universitar	Procesi	Data
<i>Raundi i parë</i>	Lista e plotë e studentëve të regjistruar në IAL	18 shtator 2022
	Kryerja e verifikimeve nga IAL-të pas marrjes së aplikimit për bursë	5 tetor 2022
	Marrja e vendimit nga Bordi i Administrimit mbi konfirmimin ose jo të aplikimit	16 nëntor 2022


Pra për të gjithë ata studentë të cilët regjistrohen gjatë raundit të parë të aplikimit universitar, pagesa e parë do duhej të ishte depozituar pranë llogarive të tyre bankare brenda muajit nëntor 2022, e kështu me rradhë deri në përfundim të vitit akademik. Pagesa për studentët

të cilët janë në vitin e tyre të dytë e tutje do duhej të fillonte gjatë muajit të fillimit të vitit të ri akademik, i cili në vitin 2022 është muaji tetor.

Pyetësori drejtuar studentëve që trajtohen me bursë meritore/socialë

Duke dashur të kuptojmë më tepër mbi situatën dhe fazën në të cilën ndodhet procesi i disbursimit të fondeve, ne kemi zhvilluar një pyetësor drejtuar studentëve të cilin e kemi shpërndarë në rrjete sociale gjatë datës 9 janar 2023. Pyetësori ka marrë në total 1072 plotësime dhe konfirmon neglizhencën e institucioneve dhe shkeljen e pikave të përcaktuara në VKM-në e mësipërme.

Si fillim kemi dashur të kuptojmë se te cilat universitete publike studiojnë studentët e anketuar. Nga analiza e të dhënave rezultoi se 41% e të anketuarve




studiojnë pranë Universitetit të Tiranës, 26% e tyre pranë Universitetit të Mjekësisë Tiranë, 17% studiojnë pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe pjesa e mbetur pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, Universitetit të Durrësit, Universitetit të Elbasanit, Universitetit të Shkodrës, dhe Universitetit të Vlorës.

Paçka se pjesa më e madhe e të anketuarve studiojnë në universitetet që ndodhën në Tiranë, është me vlerë fakti që një pjesë relevante e të anketuarve ndjekin studimet edhe në universitetet e rretheve, duke na bërë të mundur të marim një panoramë të situatës së bursave edhe në këto qytete të tjera universitare.


Dimri i gjatë i studentëve

Për sa i përket nivelit të studimit, 87% e të anketuarve studiojnë në vitin e parë Bachelor, rreth 12% në vitin e dytë dhe të tretë, ndërsa një pjesë e vogël në vitin e parë dhe të dytë master.



Edhe gjatë analizës së të anketuarve për këtë pyetje kuptojmë se kemi një pjesë të vogël studentësh në nivelin master, gjithsesi duke u bazuar në komunikimet tona me ta, na lihet të kuptojmë se edhe në këtë nivel studimi fondet e bursave nuk janë disbursuar ende në llogaritë bankare të studentëve.

Pyetjes “A ju kanë kaluar fondet e bursës në llogarinë tuaj bankare”, 98% të studentëve i përgjigjen negativisht, ndërsa një pjesë e vogël e tyre (2%), i përgjigjen pozitivisht.



Megjithatë në analizën e studentëve që janë përgjigjur pozitivisht, vihet re se në shumicën e rasteve kemi të bëjmë me fonde që kanë qënë të akumuluar edhe nga viti i kaluar akademik, çka e bën edhe më problematike situatën. Pjesa tjetër e këtyre rasteve kanë marrë vetëm 10 000 lekë në llogaritë e tyre bankare, ndërkohë që duhet t'u ishin depozituar minimalisht 35 000 lekë. Situata për studentët e nivelit master mbetet gjithashtu e njëjtë. Në këtë nivel, vetëm dy studentë kanë deklaruar që i kanë marrë fondet që u takojnë nga bursat, një prej të cilëve ka marrë shumën e plotë, pra 35 000 lekë, ndërsa studenti tjetër vetëm 10 000 lekë.

Gjetjet kryesore

- Deri më 9 janar 2023, **98%** e studentëve nuk kanë marrë asnjë pagesë nga fondi i bursave me bazë merite ose nevoje, ndërkohë që pagesat duhet të fillonin që në muajin nëntor;
- Bazuar në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016, specifikohet se studentët plotësojnë formularin e aplikimit për bursë gjatë momentit të regjistrimit në universitet dhe se fondet që u takojnë studentëve nga bursat duhet të depozitohen në llogaritë e tyre bankare çdo muaj, në mënyrë periodike. Ajo çfarë ndodh në realitet, është se studentët e plotësojnë formularin e bursës shumë më vonë se momenti i regjistrimit dhe fondet e bursave u vonohen me gati 4-5 muaj dhe u depozitohen në llogaritë e tyre në mënyrë të çrregullt.
- Për bursat me bazë merite (bursat e ekselencës), QSHA është shkaktar i vonesave të disbursimit të fondeve për studentët e sapo regjistruar në universitetet publike, duke dërguar listat e studentëve përfitues të bursës së ekselencës pranë universiteteve kur vetë ata e shohin të arsyeshme;
- Për bursat me bazë merite ose nevoje, gjatë viteve të studimit pas të parit, janë vetë universitetet të cilat vonojnë procesin duke mos u kaluar studentëve fondet në mënyrë periodike.

Rekomandime

- Duhet ndryshuar VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 duke vendosur afate kohore për QSHA në mënyrë që listat e studentëve të sapo regjistruar të cilët përfitojnë bursën e ekselencës të dërgohen pranë universiteteve sipas kohështrirjes logjike të përcaktuar në këtë VKM;
- Bordi i Adiministrimit pranë universiteteve publike duhet të disbursojë bursat e studimit në kohë dhe në respektim të kritereve dhe afateve ligjore;
- Ministria e Arsimit duhet të ushtrojë kontroll periodik në Bordin e Adiministrimit të universiteteve ndërsa këshillat studentorë pranë çdo universiteti duhet të ushtrojnë presion mbi to.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED
NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al